



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

<i>Ilaz Papaj-Ekspert Shqyrtues</i>	<i>Data e autorizimit të ekspertit</i> 09.06.2022	<i>Data e dorëzimit të raportit</i> 20.06.2022	Nr. i lëndës: 186/22
-------------------------------------	--	---	-----------------------------

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 06.06.2022, OE NPN ”Euroing”Shpk – Rahovec, ka parashtruar ankesë me nr: 186/22, kundër anulimit të aktivitetit të prokurimit, “Ndërtimi i garazhës për automjete në kampin Vrella”, me nr. të prokurimit: 214-22-1780-5-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – “Policia e Kosovës”.
Autoriteti kontraktues ka zbatuar **procedurë të hapur**, lloji i kontratës: Kontratë Publike, **Punë**, vlera e parashikuar e kontratës: **471,721.49 €**.

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

(Të përshkruhen dispozitat e shkelura dhe vetëm pikat e ankesës).

Neni 6 Ekonomiciteti dhe Efikasiteti
Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi
Neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve
Neni 60 Kriteret për Dhënien e Kontratës
Neni 69 Aftësia teknike dhe/ose Profesionale
Neni 72 Dokumentacioni dhe informacioni shtesë

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE NPN ”Euroing”Shpk–Rahovec, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Ndërtimi i garazhës për automjete në kampin Vrella”, me nr. të prokurimit: 214-22-1780-5-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – “Policia e Kosovës”

Të nderuar, OE NPN EUROING SH.P.K. me datën 30.05.2022 është njoftuar mbi vendimin e refuzimit të kërkesës për rishqyrtim nga AK, vendim i cili eliminon kompaninë tonë me arsyetimin që mungojnë dokumentet si me poshtë:

- a) *çertifikata me ISO 18001 : 2007 për siguri dhe shëndet në punë gjatë ndërtimit;*
- b) *Kontrata ose para kontrata e punës valide me punëdhënësin prej minimum 3 vitesh.*

Pas kërkesës për rishqyrtim që kemi adresuar tek AK me datë 24.05.2022 nga AK kemi pranuar pergjigje mbi refuzimin e kërkesës për rishqyrtim me datën 30.05.2022.

Argumentet e OE:

- a) Përkundër sqarimeve tona të ridërguara tek AK nuk janë përfillur ato dhe rrjedhimisht bëhet anulimi i aktivitetit të prokurimit. Duhet cekur që ne ishim më të lirët nga 5 ofertuesit pjesëmarrës në këtë aktivitet prokurimi. Përkundër sqarimeve të dorëzuara tek AK me datën 26.04.2022 në lidhje me certifikatën ISO 18001 2007 për siguri dhe shëndet në punë nuk janë marrur parasysh faktet dhe sqarimet e dërguara tek AK.

Certifikata ISO 18001 : 2007 sipas vendimeve zyrtare nga Autoritetet certifikuese të certifikatave ISO në nivel botëror kjo certifikatë është tërhequr dhe është zëvendësuar me Certifikatë ISO 45001 2018 për sistemin e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë e cila ka qenë pjesë e ofertës së dorëzuar dhe e përsëritur gjatë sqarimeve shtesë të kërkuara nga AK.

BS OHSAS 18001 has been withdrawn – upgrade to ISO 45001 now

On 31 March 2021, the globally recognized British Standard BS OHSAS 18001 will pass permanently into history. It has already been officially replaced by the new international management standard on occupational health and safety, ISO 45001. BS OHSAS has been "withdrawn" as a current standard.

Much of the DNA from BS OHSAS 18001 can be found in ISO 45001, so you'll recognize the principles but many enhancements are delivered in ISO 45001 including stronger leadership, better worker involvement and a focus on health, particularly mental health.



...making excellence a habit™

Is ISO 18001 still valid?

On 31 March 2021, the globally recognized British Standard BS OHSAS 18001 will pass permanently into history. It has already been officially replaced by the new international management standard on occupational health and safety, ISO 45001. BS OHSAS has been "withdrawn" as a current standard.

<https://www.iosh.com/media/pass-the-baton-1...> PDF

BS OHSAS 18001 has been withdrawn – upgrade to ISO ...

My organization has a BS OHSAS 18001 certificate – what does this mean for my organization?

A BS OHSAS 18001 certificate is only valid until March 31 2021. ISO 45001 replaced BS OHSAS 18001 in 2018 so if you want to maintain accredited certification, you have to 'migrate' to ISO 45001 before 31 March 2021. New certification to BS OHSAS 18001 will not be recognised after March 31 2021.

Me poshtë janë linqet zyrtare që vërtetojnë se certifikata ISO 18001 2007 nuk ekziston më dhe e njëjta zëvendësohet me certifikatën ISO 45001 2018 (Certifikatë e dorëzuar gjatë fazës ofertimit) :

<https://www.bsigroup.com/en-GB/ohsas-18001-occupational-health-and-safety/?fbclid=IwAR2XquyM9simSjueynbJ7Erl9Y6gLifcsA5dVnuGjgmfhmS3z-Ih6609uyk>

https://rigcert.al/service/iso-45001/?fbclid=IwAR3J4ErFnJu98dcUK04dloq_WCm1EdLdZwvUdDvMSUHOwA-68gVKx-OwmPU

- b) Autoriteti Kontraktues pretendon se mungojnë kontratat valide me punëdhënësin, ndërsa një gjë e tillë është argumentuar me dokumentet e dorëzuara gjatë fazës së ofertimit gjithashtu i kemi ridërguar edhe në sqarimet shitesë të kërkuara nga AK pas hapjes së tenderëve. Kontratat e të gjithë stafit të kërkuar sipas FTD janë pjesë e ofertës ku të njëjtat janë të noterizuara dhe valide, mund të argumentohen në dosjen e dorëzuar gjatë ofertimit. Edhe më keq në përgjigjen e rishqyrtimit është shkruar: “d) Kontrata ose para kontrata e punës valide me punëdhënësin prej minimum 3 vitesh” kjo përgjigje është komplet diskriminuese pasi që në dosje të tenderit të kërkuar sipas FTD është kjo kërkesë: “• Kontrata ose para kontrata e punës valide me punëdhënësin, ” Absolutisht nuk është përmendur afati i caktuar prej tre vitesh i validitetit të kontratës por është kërkuar vetëm të jenë valide kontratat e punës, siq e shpjeguam më lartë të gjitha kontratat e stafit profesional i kemi dorëzuar gjatë ofertimit ku të njëjtat janë valide, të noterizuara, me CV dhe me referenca ku i gjithë stafi profesional mund të faktohet edhe në listën e pagave të lëshuar nga ATK. Pra përgjigjia nga AK është tendencioze dhe komplet e pabazuar dhe e paarsyeshme.

***Neni 6 i LPP: Ekonomiciteti dhe Efikasiteti**

Të gjitha autoritetet kontraktuese, janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit.

***Neni 7 i LPP: Barazia në trajtim/ jo-diskriminimi**

Autoriteti kontraktues do të trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente.

***Neni 60 i LPP: Kriteret për Dhenien e Kontrates**

Autoriteti kontraktues do t'ia jap kontratën publike operatorit ekonomik që ka dorëzuar ose: 1.1 tenderin e përgjegjshëm me çmimin më të ulët;

***Neni 72 i LPP: Dokumentacioni dhe informacioni shtesë**

Kur informacioni apo dokumentacioni që duhet të dorëzohet nga operatorët ekonomikë është ose duket të jetë jo i plotë ose i gabuar, ose kur mungojnë dokumentet specifike, autoritetet kontraktuese mund të kërkojnë nga operatorët ekonomikë që të dorëzojnë, plotësojnë, sqarojnë apo kompletojnë informacionin apo dokumentacionin e duhur brenda një afati të caktuar kohor, me kusht që kërkesat e tilla bëhen në përputhje të plotë me parimet e trajtimit të barabartë dhe transparencës.

KRITERET PËR VLERËSIM

Përshtatshmëria profesionale:

Kërkesa: e) OE duhet të dëshmojë se është i certifikuar me ISO 18001 2007 për siguri dhe shëndet në punë gjatë ndërtimit

Dëshmia: e) Kopja e noterizuar e certifikatës ISO 18001 2007 Valide

Kapaciteti teknik dhe profesional:

Kërkesa: Lista e stafit profesion të operatorit ekonomik me përbërje si në vijim: •Një (1) Inxhinier i diplomuar i Ndërtimtarisë – drejtimi konstruktiv (apo master jo bachelor) me minimum përvojë pune 3 vite pas diplomimit ; Një (1) Inxhinier i diplomuar i Makineris (apo master jo bachelor) me minimum përvojë pune 3 vite pas diplomimit

Dëshmia: Lista e stafit profesional duhet të jetë e nënshkruar dhe e vulosur nga OE dhe dëshmitë për secilin inxhinierë si në vijim: Kontrata ose para kontrata e punës valide me punëdhënësin, Diploma e inxhinierëve përkatës sipas lëmis së kërkuar e noterizuar, CV-it- e inxhinierëve, Referencat mbi përvojën e punës (në referenca duhet të jen të saktësuara vitet e punës nga secili punëdhënës).

RAPORTI I KOMISIONIT VLERËSUES

Duke u bazuar në raportin e rivlerësimit, komisioni vlerësues ka konstatuar si në vijim:

Komisioni për vlerësimin, ekzaminimin dhe krahasimin e tenderëve në raportin e tyre të datës 20.05.2022, nga pesë (5) oferta të dorëzuara, të gjitha oferta i ka vlerësuar si të papërgjegjshme duke rekomanduar që të anulohet aktiviteti i prokurimit

Sa i përket ofertës së OE ankues “Euroing’Shpk -Rahovec, nga komisioni i vlerësimit kjo ofertë është shpallur e papërgjegjshme me arsyetimin :

-Mungon certifikata ISO 18001 : 2007 për siguri dhe shëndet në punë gjatë ndërtimit;

-Kontrata ose para kontrata e punës valide me punëdhënësin prej minimum 3 vitesh

- Një (1) Inxhinier i diplomuar i Ndërtimtarisë – drejtimi konstruktiv (apo master jo bachelor) me minimum përvojë pune 3 vite pas diplomimit

- Një (1) Inxhinier i diplomuar i Makineris (apo master jo bachelor) me minimum përvojë pune 3 vite pas diplomimit

INFORMACIONET SHITESË TË MARRA ME ANË TË SQARIMEVE TË KERKUARA NGA E EKSPERTËVE SHQYRTUES DHE / OSE TEKNIK

///

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP-së

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE NPN “Euroing” Shpk–Rahovec, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Ndërtimi i garazhës për automjete në kampin Vrella “, me nr. të prokurimit: 214-22-1780-5-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – “Policia e Kosovës”

(Të jepet një vlerësim se OE ankues është apo nuk është palë me interes sipas nenit 4.1.26).

///

VENDIMET E MËPARSHMETË PSH-së LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

(Të sqarohet nëse për rastin e njëjtë është dhënë vlerësim tjetër).

///

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

(Të sqarohet për rastin se pse është devijuar nga praktika e mëparshme).

///

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES “EUROING”SHPK

Përgjigje në Pretendimi nr.1

Lidhur me pretendimin e OE ankues “Euroing”Shpk, se AK gjatë vlerësimit,ekzaminimit dhe krahasimit të tenderëve ka eliminuar oferten e tyre edhe pse ofertë më e lirë me arsyetimin se mungon çertifikata ISO 18001 : 2007 për siguri dhe shëndet në punë gjatë ndërtimit, që sipas OE ankues çertifikata e dorëzuar ISO 45001:2018 për sistemin e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë e përmbush kërkesën e dosjes së tenderit sepse çertifikata ISO 18001 : 2007 nuk është më valide sipas British Standard BS OHSAS dhe AK pa të drejtë ka eliminuar ofertën e tyre duke bërë shkelje të neneve 6,7,59,60,69 dhe 72 të LPP-së,eksperti shqyrtues ka këtë mendim

Në dosje të tenderit është kërkuar që OE duhet të dëshmojë se është i çertifikuar me ISO 18001:2007 për siguri dhe shëndet në punë gjatë ndërtimit, e dëshmuar me kopjen e noterizuar të çertifikatës ISO 18001:2007 valide

Eksperti shqyrtues sqaron se OE ankues “Euroing”Shpk gjatë dorëzimit të tenderit për këtë kërkesë të dosjes së tenderit ka dorëzuar çertifikatën ISO 45001 :2018 e prezentuar më poshtë;

CERTIFICATE OF CONFORMITY

FOR OCCUPATIONAL HEALTH AND SAFETY MANAGEMENT SYSTEM PER SISTEMIN E MENAXHIMIT TE SHENDETIT DHE SIGURISE NE PUNE

Certificate No / Nr. i Certifikatës AQS/S/67852021

Name of Company / Emri i Kompanisë **NPN Euroing SH.P.K**
Numri Unik Identifikues: 811302281

Address/Adresa Xërxë, p.n. Rahovec, Prishtinë, Kosovë.

Standard / Standardi **ISO 45001:2018**

Concerning the following for services / Per fushat e aktiviteteve si me poshte:

Projection, supervision and management of project, construction, maintenance and construction of civil and industrial objects (highways, airports, roads and road infrastructure, sports facilities, water supply, sewerage, electrical installations, mechanical installations, ravages of buildings, dams, river embankments and land improvement, drainage and systems of irrigation, restorations of residential buildings, schools, hospitals, concrete walls, bridges, stairs, etc. Production of concrete prepared for construction, metallic constructions, hydro isolations, thermal insulations, etc..

Projektimi, mbikqyrja dhe menaxhimi i projekteve, ndërtimi, mirëmbajtja dhe konstruksioni i objekteve civile dhe industriale (autostrada, aeroporte, rruge dhe infrastrukturë rrugore, objekte sportive, ujesjelles, kanalizime, instalime elektrike, instalime makinerike, rrënimet e objekteve, diga, mbrojtje lumore dhe bonifikime, sisteme kullimi e vadije, restaurime objekte banimi, shkolla, spitale, mure betonarme, ura, shkallë etj. Prodhimimi i betonit të gatshëm për ndërtim, konstruksion metalike, hidroizolime, termoizolime, etj...

EA Sectors / Sektoret EA: 34/28,16

Validity of the Certificate / Vlefshmeria e Certifikates:

First Issue/ Leshimi i pare	Recertification/ Ricertifikimi	The first maintenance within	The second maintenance within	Expiry date/ Data e skencences
	07/04/2021	07/04/2022	07/04/2023	06/04/2024

The validity of the certificate is subject to respect for the conditions established in the AQS CERT Regulation. The validity of the certificate is subordinate to periodic surveillance and to a complete reassessment of 3 years intervals. To check the validity of the certificate on the web site www.aqscert.org, in section "MY CERTIFICATE". please write the name of the company and the number of the certificate.

Vlefshmeria e certifikates eshte objekt i rregullave te vendosura ne Rregulloret e AQS CERT. Vlefshmeria e certifikates nenshtrohet makaprove periodike vatore dhe merrmris te plotes con 3 vjet. Ne te kontroliar vlefshmerine e certifikates ne web site www.aqscert.org, ne seksionin "CERTIFIKATA ME", ja luteri shkruar emrin e kompanise dhe numrin e certifikates.



FULL MEMBER OF IAF,
SIGNATORY OF MUTUAL
RECOGNITION AGREEMENTS



Accredited ISO 17021:2015
No certificate US 008 dt 29.05.2018



For Certification Body

Eniola Cemo



AQSCERT Sh.p.k / Rruga Jusuf Vriani, Pallati 1, Nr.6, 1001, Tirana, Albania / www.aqscert.org info@aqscert.org

DOC FO-AQS-018

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE NPN "Euroing" Shpk-Rahovec, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Ndërtimi i garazhës për automjete në kampin Vrella", me nr. të prokurimit: 214-22-1780-5-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) - "Policia e Kosovës"

Me datë 26.04.2022 AK përmes “Letër Standarde e kërkesës për sqarimin e tenderit” ka kërkuar nga OE “Euroing”Shpk sqarime se a e posedon kopje të noterizuar të certifikatës ISO 18001 2007 Valide ?, nëse po atëherë na dërgoni kopjen nëpërmes platformës elektronike e-prokurimi.

Me datë 26.04.2022 OE “Euroing”Shpk në përgjigjen e tyre sqarojnë se certifikata ISO 8001:2007 nga data 31.03.2021 është zëvendësuar me certifikatën ISO 45001:2018 e cila është dorëzuar gjatë fazës së tenderimit dhe e cila është valide dhe e noterizuar konform kërkesës së dosjes së tenderit.

OE ankues “Euroing”Shpk në ankesën e dorëzuar në OSHP ka sqaruar edhe linqet zyrtare që vërtetojnë se certifikata ISO 18001 : 2007 nuk ekziston më dhe e njëjta është zëvendësuar me certifikatën ISO 45001 : 2018, ndërsa AK në vendimin e saj të dt.30.05.2022 nuk ka arsyetuar arsyen e eliminimit të ofertës lidhur me mungesën e certifikatës ISO 18001 : 2007.

Eksperti shqyrtues sqaron se ka verifikuar edhe ofertat e OE tjerë pjesëmarrës në këtë aktivitet të prokurimit lidhur me certifikatën ISO 18001 : 2007 dhe rezulton që të gjithë OE tjerë kanë dorëzuar certifikatën ISO 45001 : 2018 dhe nga AK të gjitha ofertat janë eliminuar me arsyetimin se mungon certifikatës ISO 18001 : 2007

Eksperti shqyrtues ka hulumtuar në internet dhe pretendimi i OE ankues se certifikata ISO 18001 : 2007 është zëvendësuar me certifikatën ISO 45001 : 2018 është i qëndrueshëm.

What is the difference between OHSAS 18001 and ISO 45001?

BSI will formally withdraw OHSAS 18001 in September 2021, at the end of the extended migration period (due to COVID-19). ISO 45001 uses the management system standard structure guideline Annex SL to allow for simplified integration with other management system standards, such as ISO 9001 and ISO 14001.

Eksperti shqyrtues konstaton se certifikata e dorëzuar nga OE ankues “Euroing”Shpk për ISO 45001:2018 e përmbush kërkesën e dosjes së tenderit dhe pretendimi ankimor është i bazuar.

Përgjigje në Pretendimi nr.2

Sa i përket pretendimit tjetër të OE ankues se oferta e tyre është eliminuar me arsyetimin se mungon kontrata ose para kontrata e punës valide me punëdhënsin prej minimum 3 vitesh për Inxhinierin e diplomuar të Ndërtimtarisë – drejtimi konstruktiv dhe Inxhinierin i diplomuar të Makinerisë, që sipas OE ankues dokumentet/dëshmitë e dorëzuara për të dy inxhinierët e plotësojnë kërkesën e dosjes së tenderit dhe në dosje të tenderit nuk është kërkuar që kontrata e punës të jetë valide me punëdhënsin prej minimum prej 3 vitesh dhe AK ka bërë vlerësimin e tenderit në kundërshtim me nenin 59 të LPP-së,eksperti shqyrtues ka këtë mendim.

Në dosje të tenderit dhe njoftimin për kontratë tek kërkesa e kapacitetit teknik dhe profesional ndër të tjera është kërkuar që OE duhet ofroj listën stafit profesional me përbërje si ne vijim: Një (1) Inxhinier i diplomuar i Ndërtimtarisë – drejtimi konstruktiv (apo master jo bachelor) me minimum përvojë pune 3 vite pas diplomimit dhe Një (1) Inxhinier i diplomuar i Makineris (apo master jo bachelor) me minimum përvojë pune 3 vite pas diplomimit e dëshmuar me kontrata ose para kontrata e punës valide me punëdhënësin, diploma e inxhinierëve përkatës sipas lëmis së kërkuar e noterizuar, CV-it- e inxhinierëve, referencat mbi përvojën e punës (në referenca duhet të jenë të saktësuar vitet e punës nga secili punëdhënës).

OE ankues gjatë dorëzimit të ofertës për inxhinier të ndërtimtarisë-drejtimi konstruktiv ka dorëzuar dokumentet për z.Kujtim Thaqi, i diplomuar me datë 29.11.2001 në fakultetin e ndërtimtarisë dhe arkitekturës - drejtimi konstruktiv (diploma e noterizuar), gjithashtu është bashkangjitur kontrata e punës e datës 06.01.2020 (e noterizuar), si dhe CV dhe referencat mbi përvojën e punës. Të njëjtat dokumente OE ankues i ka bashkangjitur edhe në përgjigjien ndaj kërkesës së AK-së për sqarime.

Për inxhinier të makinerisë, OE ankues ka dorëzuar dokumentet për Znj. Atifete Mazreku, e diplomuar në fakultetin e makinerisë në vitin 01.02.1999 (diploma e noterizuar), gjithashtu është bashkangjitur kontrata e punës e datës 06.01.2020 (e noterizuar), si dhe CV dhe referencat mbi përvojën e punës.

Eksperti shqyrtues konstaton se dokumentet e dorëzuara nga OE ankues “Euroing” Shpk për inxhinierin e ndërtimtarisë –drejtimi konstruktiv dhe inxhinieren e makinerisë e përmbushin kërkesën e dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë sepse në dosje të tenderit është kërkuar kontrata ose para kontrata e punës valide me punëdhënësin dhe nuk është kërkuar kontrata e punës valide me punëdhënësin prej minimum 3 vitesh, andaj pretendimi ankimor i OE ankues së AK në vendimin e saj të datës 20.05.2022 dhe përgjigjien ndaj kërkesës për rishqyrtim ka cekur arsye për anulim qe nuk kanë qenë kërkesë e dosjes së tenderit është i bazuar

Konsideroj që AK nuk ka bërë vlerësimin, ekzaminimin dhe krahasimin e tenderëve konform nenit 59 të LPP-së dhe kërkesave të parashtruara në dosje të tenderit, andaj rekomandoj që lënda të kthehet në rivlerësim dhe AK gjatë fazës së rivlerësimit të respektoj nenin 59 të LPP-së dhe kërkesat e parashtruara në dosje të tenderit dhe njoftimit për kontratë duke pasur parasysh edhe nenin 1 dhe 6 të LPP-së.

MENDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues **të aprovet si e bazuar**, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në **rivlerësim**

Raporti i eksperizës ti dorëzohet:

- | | |
|---------------------------|-----------------------|
| - Autoritetit Kontraktues | - “POLICIA E KOSOVËS” |
| - Panelit Shqyrtues | - OSHP |
| - OE ankues | - “EUROING” SHPK |

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE NPN “Euroing” Shpk – Rahovec, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Ndërtimi i garazhës për automjete në kampin Vrella”, me nr. të prokurimit: 214-22-1780-5-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – “Policia e Kosovës”

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE NPN **"Euroing" Shpk**–Rahovec, lidhur me aktivitetin e prokurimit
"Ndërtimi i garazhës për automjete në kampin Vrella ", me nr.të prokurimit: 214-22-1780-5-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) –
"Policia e Kosovës"